

Histori Suksesi

nga projektet e zbatuara në

Shqipëri në kuadër të Programit të

Shoqërisë Civile për
Shqipërinë dhe Kosovën

2018 - 2022



©Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim

Tiranë, Shqipëri 2022

Ky publikim është prodhuar në kuadër të “Programit të Shoqërisë Civile për Shqipërinë dhe Kosovën”, mbështetur nga Ministria e Punëve të Jashtme Norvegjeze dhe manaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) në partneritet me Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim (PSh). Përmbajtja dhe rekomandimet nuk përfaqësojnë qëndrimin zyrtar të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë.



Norwegian Embassy

“Programi i Shoqërisë Civile për Shqipërinë dhe Kosovën” mbështetet nga Ministria e Punëve të Jashtme Norvegjeze dhe manaxhohet nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) në partneritet me Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim (PSh).

Hyrje

Programi i Shoqërisë Civile për Shqipërinë dhe Kosovën është një program tre-vjeçar (2018-2021) i mbështetur nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë, e përfaqësuar nga Ambasada e Mbretërisë së Norvegjisë në Prishtinë. Organizatë udhëheqëse për zbatimin e programit është Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF), me organizatë partnere Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim.



Në Shqipëri, prej vitit 2018 janë mbështetur nëntëmbëdhjetë OJF, të cilat kontribuan në adresimin e çështjeve të ndryshme në pesë fusha tematike të programit.

| PROGRAMI I SHOQËRISË CIVILE PËR SHQIPËRINË DHE KOSOVËN



Përfituesit e granteve në Shqipëri

Përmes 3 Thirrjeve për Projekt-Propozime, programi ka mbështetur projekte në pesë fusha tematike:

32%

Mosdiskriminimi dhe barazia gjinore

21%

Mediat e pavarura

11%

Pakicat dhe grupet e marginalizuara

16%

Mbrojtja e mjedisit

21%

Lufta kundër korrupsionit

Qëllimi i përgjithshëm i programit është të mbështesë pjesëmarrjen demokratike dhe zhvillimin e një shoqërie civile të fuqishme dhe aktive në Shqipëri dhe Kosovë, e cila çon përpara procesin e anëtarësimit në BE.

3

Thirrje për Projekt- Propozime të Shpallura

7 fitues


Thirrja I

7 fitues


Thirrja II

5 fitues


Thirrja III




Mbulimi Kombëtar



Histori



sukses



Qendra “Vatra”

Viti i themelimit: 1999

Drejtor Ekzekutiv: **Brikena Puka**

Misioni



Parandalimi i trafikimit të qenieve njerëzore, dhunës në familje dhe me bazë gjinore, fuqizimi socio-ekonomik i viktimave të këtyre fenomeneve nëpërmjet informacionit, edukimit, advokimit, shërbimeve sociale, rezidenciale dhe komunitare.

Adresa:

Rruga: “Nermin Vlora Falaski”, Nr. 13.

Kati III.

Vlorë, Shqipëri.

Fiks: +355 33227048

Telefon: +355 692083339

| www.qendravatra.org.al

Rreth projektit

Sigurimi i një asistence të vazhdueshme për ri-integrimin e ish-viktimave të trafikimit në Shqipëri.

Objektivat e projektit:

Fuqizimi i statusit social dhe ekonomik i viktimave, dhe viktimave të mundshme të trafikimit për një ri-integrim të suksesshëm dhe përfshirje sociale. *Ofrimi i shërbimeve cilësore dhe aksesit në shërbimet komunitare për ish-viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit për ri-integrimin e tyre në jetën sociale. Rritja e kapaciteteve dhe koordinimit mes palëve të interesit në nivel shtetëror dhe sektorin e OJF-ve në luftën kundër trafikimit (KT), duke kontribuar në zbatimin efektiv të Politikave Kombëtare Kundër Trafikimit dhe Mekanizmit Kombëtar të Referimit.*

Fusha prioritare tematike: *Mos diskriminimi dhe barazia gjinore*

Koha e implementimit: 1/1/2019 - 31/12/2019

Mbulimi gjeografik: *Kombëtar*



Ri-integrim i suksesshëm - histori e një viktime trafikimi

Era është një vajzë 20-vjeçare, e cila është identifikuar si viktimë e trafikimit nga Policia kur ishte e mitur dhe më pas është dërguar për mbrojtje në Qendrën Psiko-Sociale Vatra. Për shkak të trafikimit, ajo kishte braktisur shkollën, ishte lënë pas dore nga familja e saj dhe ishte totalisht e pambrojtur. Ajo u mbështet në strehën Vatra nga ekipi multidisiplinar i qendrës në kuadër të programit të ri-integrimit: manaxhim rasti; mbështetje mjekësore, psikologjike dhe ligjore; forcimi i marrëdhënieve me familjen e origjinës; regjistrimi në shkollë dhe asistencë arsimore; formim profesional dhe përmirësim i aftësive sociale janë disa nga shërbimet që i janë ofruar asaj.

Kur mbushi 19 vjeç, Era filloi një punë me kohë të pjesshme në një fabrikë për përgatitjen e mozaikëve, dhe më vonë vendosi të kalonte në fazën e dytë të programit; të jetonte vetëm, e monitoruar në një banesë me qera.

Gjatë vitit 2019, Erës iu dha një apartament me qera dhe u zhvendos për të jetuar në vendin e origjinës në komunitetin e saj, pranë familjes. Gjatë kësaj kohe ajo ka punuar dhe ndjekur shkollën me kohë të pjesshme. Në fillim të vitit 2020, me mbështetjen e Qendrës Vatra, rasti i Erës u ndërmjetësua pranë Bashkisë për të përfituar nga Skema e Strehimit Social si ish viktimë e trafikimit dhe aktualisht po mbështetet nga Bashkia me bonusin e qerasë. Era paraqet progres të dukshëm në zhvillimin personal, social, akademik dhe profesional dhe është vlerësuar nga stafi i Qendrës si një rast suksesi në procesin e gjatë të ri-integrimit. Qëllimet që i ka vënë vetes e kanë motivuar për të përmirësuar jetën e saj. Ajo përfshihet gjithashtu si vullnetare në aktivitetet e organizuara nga Vatra, me një vullnet të madh për të mësuar si dhe motivuar vajza të tjera që të ndajnë historitë e tyre të shfrytëzimit dhe dhunës. Era është një nga 120 përfituesit e mbështetur me shërbime multidisiplinare nëpërmjet projektit “Sigurimi i një ndihme të qëndrueshme ri-integrimi për ish-viktimat e trafikimit në Shqipëri”, zbatuar nga Qendra Psiko-Sociale Vatra.

Fondacioni Shqiptar për Zhvillimin e Kapaciteteve Lokale (ALCDF)

10

Viti i themelimit: 20 Tetor, 2010

Drejtor Ekzekutiv: Lindita Manga

Misioni



Realizimi i jetesës së qëndrueshme dhe mirëqenies ekonomike në zonat rurale nëpërmjet fuqizimit në artikulin e kërkesës për lloje të ndryshme shërbimesh, përmirësimin strukturor të mjediseve të shërbimit dhe rritjes së efektivitetit të investimit dhe financave të përdoruesit fundor.

Adresa:

Rruga: Shyqyri Ishmi, Godina Shpresa,
25/4, Tiranë, Shqipëri.

Fiks: +355 44518628

Telefon: +355 672089375

| www.alcdf.org

Rreth projektit

Mjedis i pastër nëpërmjet një bujqësie të integruar

Objektivat e projektit:

Përmirësimi i mjedisit nëpërmjet minimizimit të ndotjes së tokës dhe ujit duke aplikuar praktika të integruara bujqësore në bashkinë Divjakë.

Fusha prioritare tematike: Mbrojtja e mjedisit

Koha e implementimit: 1/1/2019 - 31/12/2019

Mbulimi gjeografik: Bashkia Divjakë



Për fermerët e Divjakës, plehrat janë çelësi për uljen e kostove dhe mbrojtjen e komunitetit të tyre

Apostol Qato është administrator i një ferme që ndodhet në Mizë, fshat i bashkisë Divjakë. Familja e tij operon në bujqësi që nga vitet 1990 dhe ferma e tyre është identifikuar si një nga fermat më të vjetra në vend. Pasi punoi në bujqësi, në Greqi për rreth një dekadë, ai vendosi të kthehej në atdhe dhe në atë kohë u bë pjesë e projektit “Mjedis i pastër nëpërmjet një bujqësie të integruar”. Pjesëmarrja në aktivitetet e projektit si: kryerja e analizave të tokës dhe ujit përpara kultivimit të bimës, asistenca teknike, trajnimet teorike dhe demonstrimet në terren e bënë atë të mësonte disa teknika të cilat e ndihmuan të reduktonte kostot dhe të përmirësonte mënyrën se si të kujdesej për tokën e tij. Ai pranon se fermerët nuk mund t'i ndryshojnë procedurat e plehërimit brenda natës dhe përvoja e tij si fermer i vogël mund të jetë model për fermerët e tjerë. Apostoli thekson se ai ka qenë i interesuar për përfitimet afatgjata të përdorimit të këtyre teknikave dhe plehrave të kontrolluara/miratuara nga BE, veçanërisht për shëndetin e familjes së tij, për komunitetin dhe për mjedisin. Apostoli e konsideron pjesëmarrjen në projekt si një mundësi unike për të kultivuar siç duhet bimët, për të përmirësuar funksionimin dhe për të mbrojtur shëndetin e familjes dhe komunitetit të tij. Sipas tij, përfitimet mjedisore dhe ekonomike do të vazhdojnë të bëhen më të dukshme nëse fermerët do të vazhdojnë t'i zbatojnë këto teknika ndër vite. Sot Apostoli po kultivon rreth 3,2 hektarë perime. Në varësi të stinës së kultivimit, perimet që kultivon janë shalqini, pjepri, karrota, qepa, patatet etj. Ai pranon se gjithmonë ka synuar t'ua kalojë tokën fëmijëve të tij dhe kjo është arsyeja kryesore që dëshiron ta mbrojë atë më së miri dhe sa më të shëndetshme. Apostoli është pjesë e grupit prej 50 fermerësh të bashkisë Divjakë të cilët kanë përmirësuar kapacitetet e tyre nëpërmjet programeve të trajnimit dhe vizitave në terren të ofruara nga stafi i projektit. Mbështetja dhe asistenca nga projekti ka ndikuar në cilësinë e një tokë dhe vaditje më të mirë për fermat në të gjithë bashkinë.

Instituti i Studimeve Politike (ISP)

Viti i themelimit: 27 Mars, 2006

Drejtor ekzekutiv: Afrim Krasniqi

Misioni



Instituti Shqiptar për Studime Politike (ISP) është një organizatë joqeveritare që vepron në fushën e zhvillimit të demokracisë në Shqipëri. Fokusi i tij në monitorimin e procesit të tranzicionit politik, angazhimin politik, parlamentin, institucionet kushtetuese dhe edukimin e publikut duke mbështetur parimet e transparencës, pjesëmarrjes, përfaqësimit dhe njohjes së koncepteve themelore për një demokraci funksionale.

Adresa:

Rruga: "Luigj Gurakuqi", Godina A/89,
Kati 3, Apt 16A, 1001, Tiranë, Shqipëri.

Telefon: +355 684040722

Email: contactaips@isp.com.al

| www.isp.com.al

Rreth projektit

**Një parlament i pastër –
Transparenca dhe Llogaridhënia.**

Objektivat e projektit:

Pilotimi i një kuadri anti-korrupsion që synon parandalimin e konfliktit të interesit, rritjen e transparencës dhe rritjen e përgjegjshmërisë nga deputetët në lidhje me veprimtarinë e tyre parlamentare; Ngritja e një sistemi efektiv monitorimi për të gjitha vendimmarrjet politike të deputetëve, zbulimin dhe analizën e rasteve të mundshme të konfliktit të interesit; Krijimi i një tradite reagimi institucional ndaj shkeljeve të mundshme të ligjit për konfliktin e interesit nga deputetët dhe nga Kuvendi; Rritja e ndërgjegjësimit të deputetëve, parlamentit dhe aktorëve politikë dhe institucionalë për rëndësinë e praktikave të mira në fushën e parandalimit të konfliktit të interesit dhe përfshirja e komunitetit të OJF-ve, veçanërisht organizatave mbikëqyrëse dhe sinjalizuesve në diskutimin publik të konfliktit të interesit në Parlament.

Fusha prioritare tematike: *Lufta kundër korrupsionit*

Koha e implementimit: *1/1/2019 - 30/4/2020*

Mbulimi gjeografik: *Kombëtar*



Procedimi ligjor dhe gjurmimi i rastit - Rasti i z. Sadri Abazi

Bazuar në të dhënat e mbledhura si pjesë e procesit të monitorimit në kuadër të projektit “Një parlament i pastër – Transparenca dhe Llogaridhënia”, në gusht 2019, ISP i drejtoi një shkresë zyrtare Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI) duke kërkuar fillimin e hetimit për deputetin Sadri Abazi. Të dhënat e mbledhura nga ISP vërtetuan aktin flagrant të konfliktit të interesit të këtij deputeti, për disa kontrata me subjekte shtetërore dhe konkretisht me Postën Shqiptare. Situata e konfliktit të interesit u konstatua nga ISP-ja në shkelje flagrante të ligjit. Për këtë arsye është kërkuar një hetim i plotë nga ILDKPKI, e cila është përgjigjur pozitivisht duke i vendosur gjobë deputetit. Në përfundim të hetimeve të mësipërme dhe konstatimeve të mbështetura me ligj dhe prova, siç deklarohen nga ISP-ja në komunikimet dhe kërkesat e mëparshme, ILDKPKI bëri me dije se kishte vendosur, aplikimin e gjobës prej 800,000 lekësh ndaj deputetit Sadri Abazi. Puna e vlerësuar e ILDKPKI, e cila në mbështetje të dokumentacionit dhe kërkesave të ISP-së, bëri të mundur vendimin pozitiv dhe të ligjshëm të kësaj çështjeje duke marrë masa konkrete ndëshkimore. Në këto kushte, hetimet e pavarura, ndëshkimi i zyrtarëve që kanë shpërdoruar detyrën është një mesazh i qartë vendosmërie për institucionet e pavarura, si dhe krijimi i një klime të favorshme besimi publik në mbrojtjen dhe respektimin e shtetit të së drejtës në vendin tonë.

Instituti Shqiptar i Medias (AMI)

Viti i themelimit: 1996

Drejtor Ekzekutiv: Remzi Lani

Misioni



Të jetë një qendër trajnimi për gazetarët e Shqipërisë; të bashkërendojë dhe mbështesë aktivitetet në lidhje me trajnimin e gazetarëve dhe zhvillimin e medias në Shqipëri; të ndërmarrë studime dhe projekte në mbështetje të zhvillimit të medias së lirë dhe të pavarur shqiptare; të krijojë marrëdhënie me organizata të ngjashme të huaja dhe ndërkombëtare dhe të marrë pjesë në proceset ligjvënëse në fushën e medias.

Adresa: Rruga: Gjin Bue Shpata, Nr 8, Tiranë, Shqipëri.

Fiks: +355 42229800

Telefon: +355 682023952

| www.institutemedia.org

Rreth projektit

Forcimi i rolit të medias së pavarur në procesin e reformës në drejtësi në Shqipëri.

Objektivat e projektit:

Të forcojë rolin e medias shqiptare në zbatimin e reformës në drejtësi në Shqipëri; Të përmirësojë aftësitë dhe kapacitetet profesionale të gazetarëve shqiptarë në raportimin e çështjeve të drejtësisë.

Fusha prioritare tematike: *Mediat e pavarura*

Koha e implementimit: *1/2/2019 - 1/2/2020*

Mbulimi gjeografik: *Tiranë*



Trajnim i Akademisë së Medias për Reformën në Drejtësi

Në kuadër të projektit “Forcimi i rolit të medias së pavarur në procesin e reformës së drejtësisë në Shqipëri”, zbatuar nga Instituti Shqiptar i Medias, një numër prej 20 gazetarësh përfituan nga trajnimi i Akademisë së Medias për të mësuar se si të mbulojnë mediatikisht procesin e reformës në drejtësi. *Pas përfundimit të Akademisë dhe një procesi intensiv trainimi dhe mentorimi nga Instituti Shqiptar i Medias (AMI), me mbështetjen e projektit janë përgatitur dhe publikuar 29 artikuj, në vend të 20 të planifikuar.* Në këtë proces, nëntë nga artikujt nuk ishin të një niveli të duhur për t'u botuar dhe AMI ftoi nëntë gazetarë të tjerë, më me përvojë, për të mbuluar këtë temë.

Në këtë kuadër, AMI vazhdoi me trajnimin e mëtejshëm të nëntë gazetarëve që nuk kishin publikuar ende artikujt e tyre, dhe nën kujdesin e trajnerëve, gazetarët arritën të publikojnë shkrimet e tyre. Si rezultat, 29 artikuj për reformën në drejtësi u publikuan online në media të ndryshme. Gazetarët u fokusuan në çështje të ndryshme dhe morën qasje të ndryshme gjatë raportimit të reformës në drejtësi. Një pjesë e konsiderueshme e shkrimeve u fokusuan tek procesi i vetingut, si pjesa më interesante dhe publike e reformës në drejtësi. Ky ishte një aktivitet dhe rast i rëndësishëm për gazetarët, pasi i gjithë procesi u mundësoi gazetarëve të kalonin nëpër një proces më të ngadaltë dhe më reflektues në shkrimin dhe raportimin e reformës në drejtësi, duke u fokusuar në ndikimin e saj, por edhe duke analizuar problemet, sfidat dhe efektet. Kjo vluu si për gazetarët me përvojë ashtu edhe për gazetarët e papërvojë, pasi ata punojnë në të njëjtin mjedis.

Shoqata “Ndihamoni Jetën”

Viti i themelimit: 14 Shtator, 1998

Drejtor Ekzekutiv: Afërdita Seiti

Misioni



Përmirësimi i kapaciteteve dhe ndryshimi i statusit social të fëmijëve, adoleshentëve, të rinjve dhe grupeve të tjera që janë me aftësi të kufizuara mbi këtë moshë. Mbrojtja e të drejtave të tyre për t'i integruar në shoqëri.

Adresa: Rruga: Fshati Prush, Njësia Administrative Vaqarr, Tiranë, Shqipëri.

Fiks: +355 44803370

Telefon: +355 682084945

Email: info@helphelife.org.al

| www.helphelife.org

Rreth projektit

Ndërhyrja e hershme, domosdoshmëri për avancimin e zhvillimit të fëmijës.

Objektivat e projektit:

Përmirësimi i programeve në mbështetje të fëmijëve me aftësi të kufizuara në drejtim të zhvillimit të tyre mendor, social dhe arsimor dhe ndihma që ata të kenë një jetë më produktive dhe të pavarur në të ardhmen. Krijimi i një ndërhyrjeje ndërsektoriale që ofron shërbime mbështetëse për fëmijët me aftësi të kufizuara në moshë të hershme.

Fusha prioritare tematike: *Pakicat dhe grupet e marginalizuara*

Koha e implementimit: *1/1/2019 - 31/4/2020*

Mbulimi gjeografik: *Tiranë*



Rasti i “R”, një prej fëmijëve me çrregullim të spektrit autik

Kur filloi të frekuentonte kopshtin, "R" shfaqti shumë vështirësi në zhvillimin e marrëdhënieve shoqërore me fëmijët e tjerë gjatë lojërave, orëve edukative dhe aktiviteteve të tjera zhvillimore. Sipas mësueses të tij, R, ka shfaqur vështirësi në kuptimin dhe zbatimin e disa udhëzimeve, ai gjithashtu shfaqte sjellje mjaft të përsëritura dhe nuk arrinte të përqendrohej. Krahas vështirësive, mësuesja e tij thekson se edhe për të ishte e vështirë të punonte me fëmijën duke pasur parasysh se në të njëjtën kohë duhej të punonte edhe me pjesën tjetër të grupit. Ndërkohë, ajo pranon se situata ndryshoi pasi nisi të merrte pjesë në trajnimet dhe seancat e asistencës teknike të zhvilluara nga shoqata “Ndihamoni Jetën” ku u aftësua përmes teknikave profesionale në drejtim të mbështetjes së fëmijëve me nevoja të veçanta. Ajo deklaroi se tani është më e përgatitur se si të komunikojë, si të udhëzojë, si të angazhojë fëmijën në grupe dhe si të manaxhojë disa sjellje të papërshtatshme të tij. Sipas saj, R ka bërë përmirësime të shpejta, është përfshirë më shumë në lojrat me bashkëmoshatarët dhe ka fituar disa aftësi sociale që lehtësojnë ndërveprimin e tij shoqëror. Përmirësimet e tij kanë qenë të dukshme për prindërit, familjen dhe fëmijët e tjerë brenda kopshtit.

Stafi i “Avatar 28” e konsideron rastin e tij si një histori suksesi për shkak të përmirësimit të tij të ndjeshëm që erdhi menjëherë pas angazhimit të mësuesve të tij në trajnimet dhe seancat e asistencës teknike të ofruara nga shoqata “Ndihamoni Jetën”. Raste të ngjashme si e kësaj mësueseje, në qytetin e Tiranës kanë qenë 300 edukatorë të 79 institucioneve të arsimit parashkollor të cilët janë mbështetur nga shoqata “Ndihamoni Jetën” dhe kanë përmirësuar aftësitë e tyre në kuadër të projektit “Ndërhyrja e hershme, domosdoshmëri për avancimin e zhvillimit të fëmijës”.

Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS)

Viti i themelimit: 2006

Drejtor Ekzekutiv: Raimonda Bozo

Misioni



Plotësimi i nevojave ligjore dhe sociale të njerëzve në nevojë, edukimi dhe rritja e ndërgjegjësimit të shoqërisë shqiptare mbi shtetin e së drejtës dhe të drejtat e njeriut; iniciativa për përmirësimin e sistemit ligjor, zhvillimi i komunitetit dhe forcimi i demokracisë në Shqipëri.

Adresa:

Bulevardi "Bajram Curri", Godina "Agimi", Hyrja.18, Apt.322, Tiranë, Shqipëri.

Fiks: +355 225844

Telefon: +355 692087930

| www.tlas.org.al;

| www.portal.tlas.org.al;

Rreth projektit

Rritja e përfshirjes sociale përmes aksesit në drejtësi

Objektivat e projektit:

Objektivi i përgjithshëm i këtij projekti është të ndihmojë aksesin në drejtësi që u mundëson pakicave dhe grupeve të marginalizuara të gëzojnë të drejtat e tyre dhe të sigurojë përfshirjen e tyre në programet sociale shtetërore.

Fusha prioritare tematike: *Pakicat dhe grupet e marginalizuara*

Koha implementimit: 1/1/2019 - 31/12/2019

Mbulimi gjeografik: *Elbasan, Librazhd, Gramsh, Peqin, Cërrik, Shkodër, Malësi e Madhe, Pukë, Tiranë dhe Rrogozhinë.*



Kujdestaria ligjore për një fëmijë pa përgjegjësi prindërore

Pas arrestimit të prindërve të saj pasi u zbulua se mbanin lëndë narkotike për qëllime trafiku, A.Ç - një vajzë tashmë 4 vjeçare, lindi në burgun e Edirne-Turqi.

Në vitin 2016, gjykata turke dha vendimin përfundimtar për prindërit e A.Ç., të cilët u dënuan me 25 vite burg dhe fëmija kaloi vitin e parë të jetës së saj në burg së bashku me nënën e saj. Më pas, fëmija u mor nga burgu ku qëndronte me nënën e saj dhe filloi të jetonte me gjyshërit e saj që u kujdesën për të që prej fillimit të vitit 2017, por pa pasur asnjë titull ligjor apo vendim gjykate për marrjen e saj në kujdestari. Çështja i'u referua TLAS në janar 2019 nga Zyra e Gjendjes Civile e Njesisë Administrative nr. 6, në Tiranë dhe është mbyllur më 16 Dhjetor 2019. TLAS intervistoi fillimisht gjyshërit e fëmijës dhe mblodhi të gjithë informacionin dhe dokumentet e nevojshme ligjore. Më pas, u desh të hapej një procedurë gjyqësore për të caktuar gjyshërit si kujdestarë ligjorë të fëmijës. Për situatën në fjalë, shteti nuk ka ndërmarrë asnjë masë për sigurimin e jetës së fëmijës dhe nga ana tjetër, familja ka qenë veçanërisht vulnerabël dhe pa asnjë mbështetje sociale dhe e pamundur për të ndjekur një procedurë ligjore për marrjen e kujdestarisë së fëmijës.

Pas përfaqësimit me sukses të çështjes nga TLAS, më në fund A.Ç. do të ketë një ambient jetese më të sigurt, gjendja e saj është dukshëm më e mirë dhe mbështetja sociale është përmirësuar. A.Ç. është një nga 344 përfituesit (194 prej tyre vijnë nga minoritetet) mbështetur me një sërë shërbimesh të ndihmës ligjore nëpërmjet projektit "Rritja e përfshirjes sociale përmes zgjidhjes së të drejtave ligjore", zbatuar nga Shërbimi Ligjor Falas Tiranë.

Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza

Viti i themelimit: 1996

Drejtor Ekzekutiv: Iris Luarasi

Misioni



Të promovojë, advokojë dhe garantojë të drejtat e grave në Shqipëri. Të punojë drejt arritjes së barazisë gjinore.

Adresa:

Rruga: "Muhamet Gjollësia", Ndërtesa.
122, Hyrja.4, Apt.8, 1023,
Tiranë, Shqipëri.

Fiks: +355 42233408

Linja telefonike: 116 117

| www.hotlinealbania.org

Rreth projektit

Promovimi i barazisë gjinore në Shqipëri: Një qasje multidisiplinare përmes ngritjes së kapaciteteve dhe ofrimit të shërbimeve për gratë.

Objektivat e projektit:

Të sigurohet barazia gjinore dhe të reduktohet diskriminimi me baza gjinore duke ofruar shërbime për gratë, viktime të dhunës me bazë gjinore dhe ngritja e kapaciteteve të profesionistëve përkatës.

Fusha prioritare tematike: Mos diskriminimi dhe barazia gjinore

Koha e implementimit: 7/1/2019 - 7/1/2020

Mbulimi gjeografik: Shkodër, Lezhë, Malësi e Madhe, Tiranë, Durrës, Krujë, Elbasan dhe Bulqizë.



Një program trajnimi për studentët e Shkollës së Magjistraturës

13 studentë të Shkollës së Magjistraturës, gjyqtarë dhe prokurorë, janë trajnuar nga Linja e Këshillimit për Gratë dhe Vajzat mbi nocionet e barazisë gjinore, integrimin gjinor në sistemin e drejtësisë, diskriminimin gjinor në gjykata, dhunën me bazë gjinore, programet e rehabilitimit të dhunuesve, etj. Trajnimi ishte mjaft unik për ta, pasi rrallëherë trajnohen për çështjet e barazisë gjinore dhe dhunës me bazë gjinore. Nga ana tjetër, atyre nuk u është dhënë më parë informacioni i duhur nga ekspertët e duhur. Të pranishmit u sensibilizuan për temat e lartpërmendura dhe u qartësuan mbi përdorimin e terminologjisë së duhur në punën e përditshme, veçanërisht kur bëhet fjalë për çështjet gjyqësore. Trajnerët trajtuan gjithashtu çështjen e stereotipizimit dhe diskriminimit gjinor në gjykata dhe metodat se si t'ë sfidohen dhe shmangen ato. Në fund të trajnimit, njohuritë e gjyqtarëve dhe prokurorëve të ardhshëm mbi çështjet e barazisë gjinore, stereotipeve gjinore dhe diskriminimit në gjykata, dhunës me bazë gjinore dhe shërbimeve sociale që u ofrohen viktimave të kësaj dhune, u përmirësuan ndjeshëm. Përpara trajnimit, studentët e Shkollës së Magjistraturës kishin pak ose aspak informacion mbi to. Pas trajnimit u përmirësuan njohuritë dhe ndërgjegjësimi i tyre për këto çështje. Është thelbësore për arritjen e barazisë gjinore dhe eliminimin e diskriminimit gjinor në sistemin e drejtësisë, që gjyqtarët dhe prokurorët të sensibilizohen dhe të informohen për implikimet e barazisë gjinore në punën e tyre. Paralelisht, gjatë zbatimit të projektit, Linja e Këshillimit ka qenë në gjendje të këshillojë 3010 gra kryesisht viktime të dhunës me bazë gjinore dhe të kryejë një program rehabilitimi me 80 meshkuj dhunues.

Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (FSHDPAK)

22

Viti i themelimit: 1996

Drejtor Ekzekutiv: **Blerta Çani Drenofci**

Misioni



Promovimi i mundësive të barabarta dhe mbrojtjes së vazhdueshme të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara duke synuar përmirësimin e cilësisë së jetës së tyre dhe të familjeve të tyre.

Adresa:

Rruga: Bogdani. Apt. 15, Tiranë,
Shqipëri, 1001.

Fiks: +355 42269426

Telefon: +355 682049160

E-mail: adrf@albmail.com

| www.adrf.al

Rreth projektit

Barazia, mosdiskriminimi dhe përfshirja e personave me aftësi të kufizuara përmes vetë-advokimit.

Objektivat e projektit:

Të promovojë respektimin e të drejtave të njeriut të personave me aftësi të kufizuara në Shqipëri, nëpërmjet zbatimit të mosdiskriminimit dhe përfshirjes. Fuqizimi i komunitetit të personave me aftësi të kufizuara për të kërkuar të drejtat e tyre për anti-diskriminimin dhe përfshirjen dhe përmirësimin e aksesit në njohjen e të drejtave të njeriut dhe legjislacionin e aftësisë së kufizuar, veçanërisht për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi ndërmjet aktorëve shtetërorë dhe joshtetërorë si parakushte për eliminimin e diskriminimit dhe ndikimit në përfshirjen sociale.

Fusha prioritare tematike: *Mosdiskriminimi dhe grupet e marginalizuara*

Koha e implementimit: 15/1/2020 - 15/01/2021

Mbulimi gjeografik: *Tiranë, Elbasan, Shkodër, Vlorë.*



Ankesë për diskriminim ndaj F.R., fëmijë me aftësi të kufizuara

Në prill 2020, një djalë 14-vjeçar me Sindromën Down u diagnostikua me leucemi akute dhe një javë pas marrjes së diagnozës ai u shtrua në Qendrën Spitalore Universitare Nënë Tereza (QSUT) në departamentin e Onkohematologjisë. Kostot e medikamenteve nuk mbuloheshin nga (QSUT) edhe pse F.R. ishte një pacient i shtruar. Fëmijës iu rekomandua terapi me Metotreksat, një nga barnat thelbësore për luftimin e sëmundjes. Vlen të theksohet se çmimi i medikamentit është jashtëzakonisht i lartë ndërsa mungesa e barnave për fëmijët me leucemi në QSUT është kthyer në një problem prej disa kohësh. Prindërit e F.R., në emër të fëmijës së tyre të mitur, me asistencën e Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Down Syndrome Albania nisën një kërkesë pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Bazuar në nenet 32, 33, të ligjit nr. 10 221, datë. 04.02.2010, "Për mbrojtjen nga diskriminimi", prindërit e F.R. i kërkuan Komisionerit të kryejë të gjitha hetimet e nevojshme dhe të urdhërojë masat e nevojshme:

- Sigurimi i rimbursimit të plotë nga institucionet shtetërore për shpenzimet e F.R.
- Sigurimi i informacionit dhe publikimi i buxhetit real për trajtimin e çështjeve në 10 vitet e fundit dhe njoftimi i palëve të interesuara;
- Parashikim sistematik të barnave për fëmijët me leucemi në QSUT.

Ky është një nga 20 rastet e identifikuara dhe drejtuar institucioneve përkatëse nga individë të organizatave të aftësisë së kufizuar, personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre në kuadër të projektit "Barazia, mosdiskriminimi dhe përfshirja e personave me aftësi të kufizuara përmes vetë-advokimit", zbatuar nga FSHDPAK. Projekti ka promovuar respektimin e të drejtave të njeriut të personave me aftësi të kufizuara në Shqipëri nëpërmjet zbatimit të mosdiskriminimit/përfshirjes dhe nëpërmjet ndërhyrjeve gjithëpërfshirëse.

Forumi i mendimit të lirë

Viti i themelimit: 2006

Drejtor Ekzekutiv: Mentor Kikia

Misioni



Të ndërmerren nisma ligjore dhe sociale në drejtim të përmirësimeve të pushtetit vendor dhe qendror. Të rrisë llogaridhënien e qeverisë dhe të promovojë aktivizmin social në shërbim të llogaridhënies, si dhe përmirësimin e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe medias.

Adresa:

Rruga: "Artan Lenja", Ndërtesa. 6, Apt. 13, Laprakë, Tiranë, Shqipëri.

Fiks: +355 42270478

Telefon: +355 692021604

| www.fml.al

Rreth projektit

Liria e medias nën kërcënimet e zyrave të Marrëdhënieve me Publikun të institucioneve publike

Objektivat e projektit:

Të japë të dhëna dhe dëshmi për shkallën e fenomenit të transmetimit të lajmeve të gatshme në mediat vizive, si dhe të identifikojë dhe denoncojë mekanizmat që shkaktojnë censurimin e lirisë së medias për të raportuar në mënyrë të pavarur veprimtarinë e qeverisë dhe partive politike.

Fusha prioritare tematike: *Mediat e pavarura*

Koha e implementimit: *15/1/2020 – 14/1/2021*

Mbulimi gjeografik: *Kombëtar*



Reagimi i komunitetit të gazetarëve ndaj materialeve të gatshme mediatike

Bazuar në të dhënat e mbledhura në kuadër të projektit “Liria e medias nën kërcënimet e zyrave të Marrëdhënieve me Publikun” të institucioneve publike” gjatë periudhës janar 2020-janar 2021, Forumi i Mendimit të Lirë arriti për herë të parë të bëjë publike opinionet e gazetarëve dhe redaktorëve që pranuan të shpreheshin dhe denoncojnë praktikën e lajmeve të gatshme dhe shkeljen e standardeve profesionale të gazetarisë. 18 gazetarë dhe redaktorë folën për mungesën e komunikimit me zyrat e shtypit të cilat nuk i kanë njoftuar apo lejuar të marrin pjesë në aktivitetet e organizuara nga institucionet publike ku marrin pjesë zyrtarë të lartë. Gazetarët dhe redaktorët denoncuan praktikën e materialeve të gatshme të institucioneve, përmes intervistave dhe fokus grupeve që Forumi i Mendimit të Lirë zhvilloi me to. Raporti përfundimtar i përgatitur nga Forumi i Mendimit të Lirë paraqet një denoncim domethënës të cënimit të lirisë së medias në Shqipëri, duke theksuar refuzimin e gazetarëve për të marrë pjesë në aktivitete të organizuara nga institucionet publike dhe partitë politike. Sipas organizatës, kjo është një praktikë unike për nga përmasat dhe një valvul shumë e rëndësishme e frymëmarrjes mediatike, e cila aktualisht është e bllokuar nga interesi politik i qeverisë dhe partive politike. Ndërkohë përfitues janë komuniteti i gazetarëve, komuniteti mediatik dhe e gjithë shoqëria e cila do të përfitojë nga një informacion më i saktë, më i drejtë dhe më profesional.

Lëvizja Evropiane në Shqipëri (EMA)

26

Viti i themelimit: 2007

Drejtor Ekzekutiv: Gledis Gjipali

Misioni



EMA synon të krijojë një model evropian në shoqërinë shqiptare. EMA do të angazhohet veçanërisht në përhapjen e ideve dhe frymës evropiane brenda Republikës së Shqipërisë; do të angazhohet në procesin e integritimit të Shqipërisë, në përfaqësimin e vlerave thelbësore të integritimit në BE; dhe do të punojë për një përfshirje aktive të Shqipërisë për të qenë pjesë e Evropës dhe për të promovuar një Evropë më të bashkuar.

Adresa:

Bulevardi. Gjergj Fishta, Godina 3, Apt.
2/1, 1001 Tiranë, Shqipëri.

Fiks: +355 46306280

[| www.em-al.org](http://www.em-al.org)

Rreth projektit

Portali Online "EuroSpeak"

Objektivat e projektit:

Qëllimi i përgjithshëm i projektit është të sigurojë krijimin e një medie të përditshme analitike të pavarur në internet, e cila do të plotësojë në mënyrë specifike mbulimin e kufizuar aktual të temave të BE-së, duke u përpjekur të ofrojë një analizë cilësore, të pavarur që shkon përtej listimit të fakteve ose deklaratave të politizuara.

Fusha prioritare tematike: *Mediat e pavarura*

Koha e implementimit: *1/1/2020 - 30/4/2021*

Mbulimi gjeografik: *Shkodër, Elbasan, Durrës, Vlorë, Tiranë, online.*



Rekomandime për metodologjitë e reja që mund të përdoren për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies

Pandemia e Covid-19 solli shumë ndryshime në jetën tonë sociale dhe ekonomike. Ajo ndryshoi shumë koncepte të jetës së përditshme, duke na njohur me situata, si puna nga shtëpia apo shkolla nga shtëpia. Për sistemin tonë arsimor Covid-19 ishte si një goditje rrufeje dhe shërbeu për të stimuluar reagimin në nivel institucional dhe familjar në zhvillimin e mëtejshëm të kurrikulës sonë arsimore me standarde të reja. Gjithashtu, për të rritur ndërgjegjësimin për nevojën e përditësimit të metodologjisë së mësimdhënies, Dr. Aida Magjistari Myrto iu përgjigj një prej thirrjeve të hapura të EuroSpeak për të kontribuar me artikuj. Aida në shkrimin e saj, krahas prezantimit të situatës aktuale, jep rekomandime për metodologji të reja që mund të përdoren për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies. Artikulli i Aidës është ndër më të lexuarit në EuroSpeak, kryesisht si rezultat i këtyre rekomandimeve.

Pas publikimit të artikullit në EuroSpeak, emisioni i mëngjesit “Dita Jonë” në televizionin A2CNN e ftoi autoren të diskutonte më gjerësisht këtë temë. Promovimi i mediave tona online përmes mediave të tjera, veçanërisht atyre tradicionale si TV, është një tregues se EuroSpeak nuk ka qenë vetëm një pikë referimi për qytetarët, por edhe për gazetarët dhe ekspertët e fushës, si në këtë rast. Referencat dhe citimet e artikullit së EuroSpeak nga media të tjera në vend, tregojnë domosdoshmërinë e ekzistencës së këtij portali online në mjedisin shqiptar.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH)

28

Viti i themelimit: 19 Dhjetor, 1990

Drejtor Ekzekutiv: Erida Skëndaj

Misioni



Misioni i KShH është të kontribuojë për respektimin e të drejtave të njeriut, forcimin e shtetit të së drejtës, si dhe zhvillimin e zgjedhjeve të lira e të ndershme, në përputhje me Kushtetutën dhe me aktet ndërkombëtare të zbatueshme në Republikën e Shqipërisë.

Rreth projektit

Fuqizimi i pushtetit vendor për zbatimin e Ligjit për "Sinjalizuesit".

Objektivat e projektit:

Objektivi i përgjithshëm i këtij projekti është të rrisë ndërgjegjësimin dhe besimin e publikut në legjislacionin për sinjalizuesit, duke kontribuar në luftën kundër korrupsionit në Shqipëri nëpërmjet një zbatimi më të mirë të Ligjit për sinjalizuesit, në nivel vendor.

Zona prioritare tematike: *Lufta kundër korrupsionit*

Koha e implementimit: *15/1/2020 - 15/1/2021*

Mbulimi gjeografik: *Tiranë, Durrës, Elbasan, Shkodër, Lezhë, Kukës, Vlorë, Dibër, Gjirokastrë dhe Korçë.*

Adresa:

Rruga: Brigada e VIII, "Tekno Projekt",
Hyrja 2, Apt.10,Kati 6-të, Tiranë,
Shqipëri

Fiks: +355 42233671

Telefon: +355 682023699; 694075732

| www.ahc.org.al



Respektimi i së drejtës për transparencë ndaj publikut të gjerë, nga Bashkia Tiranë

Gjatë monitorimit të kryer nga KShH, rezultoi se 10 bashkitë më të mëdha të vendit tonë ishin larg standardeve të parashikuara nga Direktiva 2019/1937. Programet e transparencës të secilës bashki nuk kanë zbatuar rekomandimet e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, duke mos siguruar mekanizmat e duhura për të bërë publike informacionin mbi ekzistencën e njësisë përgjegjëse për sinjalizimin. Gjithashtu, forma të ndryshme të mekanizmave për transmetimin elektronik të rasteve të sinjalizimit janë ofruar nga bashki të ndryshme. Në shumicën e rasteve u konstatua se Bashkitë kishin seksione të veçanta për kontaktin me kryetarin apo koordinatorin për të drejtën e informimit, por në asnjë rast për kontaktin me njësinë përgjegjëse për sinjalizimin. Bashkia e Tiranës, e cila është e vetmja Bashki që ka regjistruar një sinjalizim nga "sinjalizuesit", e manaxhoi dhe e trajtoi kete rast nga njësia përgjegjëse, si rrjedhojë e informimit në kuadër të projektit të ndërmarrë nga KShH, duke ndërmarrë një veprim mjaft pozitiv dhe duke krijuar një model të rëndësishëm në interes të transparencës ndaj publikut. Në shkurt 2021, në seksionin "Programi i Transparencës", Bashkia ka përfshirë informacionin e nevojshëm në lidhje me kuadrin ligjor për sinjalizimin dhe ka promovuar publikisht adresën e e-mailit të administruar nga Njësia Përgjegjëse për Sinjalizuesit: sinjalizim@tirana.al. Tashmë çdo zyrtar apo ish-zyrtar i interesuar mund ta drejtojë sinjalizimin e tij në mënyrë elektronike pranë Njësisë Përgjegjëse për Sinjalizim pranë Bashkisë së Tiranës, pa frikën se do t'i cënohet e drejta e konfidencialitetit.

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM)

30

Viti i themelimit: 25 Nëntor, 1999

Drejtor Ekzekutiv: Sotiraq Hroni

Misioni



Misioni i IDM është avancimi i kapaciteteve shoqërore, gjenerimi dhe ndarja e njohurive, aftësive dhe ekspertizës për një politikëbërje gjithëpërfshirëse bazuar në dëshmi, për të forcuar demokracinë dhe zhvillimin e qendrueshëm.

Adresa:

Rruga: Shenasi Dishnica, Ndërtesa. 35,
Hyrja.1, 1017. Tiranë, Shqipëri.

Fiks: +355 42400241

Telefon: +355 682049345

[|www.idmalbania.org](http://www.idmalbania.org)

Rreth projektit

Monitorimi i transparencës dhe përgjegjshmërisë në nivelin e vetëqeverisjes vendore.

Objektivat e projektit:

Projekti synon të kontribuojë në reduktimin e korrupsionit në nivelin e qeverisjes vendore në Shqipëri nëpërmjet përmirësimit të transparencës dhe llogaridhënies së bashkive (duke forcuar kapacitetet monitoruese qytetare).

Fusha prioritare tematike: *Lufta kundër korrupsionit*

Koha e implementimit: 15/1/2020 - 15/4/2021

Mbulimi gjeografik: *Shkodër, Lezhë, Kukës, Dibër, Durrës, Tiranë, Elbasan, Fier, Berat, Vlorë, Korçë, Gjirokastër.*



Forcimi i kapaciteteve të organizatave lokale - një rast i “Tjetër Vizion” Elbasan

Gjatë periudhës maj-tetor 2020 IDM forcoi kapacitetet e organizatës lokale “Tjetër Vizion” Elbasan për të monitoruar dhe vlerësuar Programin e Transparencës (PT) në bashkinë Elbasan. Nëpërmjet asistencës teknike të IDM, organizata monitoroi dhe vlerësoi PT dhe përgatiti një raport monitorimi mbi “Transparencën dhe Përgjegjshmërinë në nivel vendor”. Hapësira nën "Programin e Transparencës" me performancën më pak të mirë, ishte “Tjetër Informacion”, ku Bashkia hezitoi të publikonte informacione mbi komunitetin, të dhëna për OSHC-të dhe raporte të pavarura. Bashkia ka demonstruar jo gatishmëri dhe kapacitet të kufizuar për të dhënë informacione veçanërisht në fushën e transparencës financiare dhe llogaridhënies. Gjithashtu, përkundër rëndësisë së madhe që ka ky komponent në drejtim të informimit publik, bashkia ka dhënë informacion të kufizuar. Pas ushtrimit të monitorimit, u organizua një takim dialogu me komunitetin, për të ndarë dhe konsultuar raportin e monitorimit me stafin e bashkise dhe aktorët kryesorë lokalë. Gjithashtu, zyrtarë të nivelit të lartë nga Bashkia, si nënkryetari i Bashkisë Elbasan dhe staf akademik të nivelit të lartë, si zëvendësdekani dhe zëvendësrektori i Universitetit të Elbasanit, si dhe OSHC-të dhe media lokale iu bashkuan tryezës dhe dhanë komentet e tyre konstruktive mbi raportin e monitorimit. Dialogu në komunitet shërbeu si një platformë e gjerë për të promovuar transparencën dhe përgjegjshmërinë përmes përdorimit të advokasisë bazuar në fakte. Gjetjet e raportit inkurajuan Bashkinë Elbasan të rrisë nivelin e transparencës nëpërmjet publikimit proaktiv të informacionit në Programin e Transparencës. Raporti ishte veçanërisht i dobishëm për stafin e lartë bashkiak, të cilët shfaqën gatishmërinë e tyre për të marrë parasysh të gjitha rekomandimet dhe për të rishikuar/përditësuar Programin e Transparencës në përputhje me rrethanat. Angazhimi aktiv i përfaqësuesit nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit ishte i rëndësishëm për të krijuar sinergji ndërmjet stafit të institucionit dhe për të krijuar mekanizma më të mira të komunikimit mes tyre. Pjesëmarrja e grupeve të interesit ishte shumë e rëndësishme, duke pasur parasysh se ata kanë një rol vendimtar në pronësinë e procesit, dhe shërbejnë si mekanizma të brendshëm mbikëqyrës për të siguruar zbatimin e Programit të Transparencës nga administrata bashkiake. Për më tepër, organizata lokale ka tani më shumë ekspertizë për të monitoruar të drejtën për informim në nivel lokal dhe mund të veprojë si mobilizuese në nivel komuniteti për të angazhuar aktorë të tjerë jopublikë që të veprojnë si mbikëqyrës. Ajo ka potencialin të ushtrojë rolin e saj mbikëqyrës ndaj pushtetit vendor, pasi është e pajisur me kapacitetet dhe aftësitë e nevojshme praktike.

Qendra Burimore Mjedisore (REC) Shqipëri

32

Viti i themelimit: 2018

Drejtor Ekzekutiv: Mihallaq Qirjo

Mission



Ndihma në mbrojtjen e mjedisit, mbrojtjen e vlerave natyrore dhe zhvillimin rajonal si dhe integrimin evropian nëpërmjet zhvillimit, promovimit dhe zbatimit të metodologjive të reja për ndryshim brenda konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm të vendit, duke shërbyer si partner, qendër trajnimi dhe kualifikimi, qendër burimore ekspertësh dhe konsultimi mbi politikat e ndryshme të zhvillimit të shoqërisë dhe organizatave publike dhe private. REC Albania kontribuon drejtpërdrejt në Planin Global të Veprimit të UNESCO-s 2013 për Arsimin për Zhvillim të Qendrueshëm (ESD) dhe Strategjinë e UNECE për ESD dhe lehtëson arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qendrueshëm të Kombeve të Bashkuara duke ndërtuar kapacitete në lidhje me Agjendën e Kombeve të Bashkuara 2030 për Zhvillim të Qendrueshëm. REC Albania synon rritjen dhe aktivizimin e burimeve njerëzore nëpërmjet promovimit të formimit profesional për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm të vendit

Rreth projektit

NET-CLIMATE: “Rrjetëzimi si një mjet për nxitjen e ndryshimeve klimatike në Shqipëri”.

Objektivat e projektit:

Të inkurajojë pjesëmarrjen aktive të shoqërisë civile në hartimin e politikave dhe të kontribuojë në përmbushjen e detyrimeve të Shqipërisë në kuadër të Veprimit Global për Ndryshimet Klimatike.

Fusha prioritare tematike: Mbrojtja e mjedisit

Koha e implementimit: 1/1/2020 - 31/3/2021

Mbulimi gjeografik: Kombëtar

Address:

Str: Ismail Qemali, No.27, Tirana, 1001,
Albania, P.O. Box 127

Phone: +355 42232928

Mobile: +355 682038727

| www.recshqiperi.org



“E premtë për të ardhmen” - duke trajtuar çështjet e ndryshimeve klimatike

Ka më shumë se një vit që kur grupet e para të të rinjve nisën të shfaqen të premtëve përgjatë bulevardit kryesor të Tiranës. Shumë të rinj në Shqipëri e kanë përmendur prej disa vitesh çështjen e ndryshimeve klimatike si një çështje madhore, por këto zëra u mbytën nga moria e çështjeve të tjera apo indiferenca. Endri Haxhiraj, i cili drejton Institutin për Politika Mjedisore, një OJF lokale, mori drejtimin e organizimit të këtyre ngjarjeve. Shumë të rinj në Shqipëri e panë atë si mundësinë më të mirë për të ngritur zërin. Ina, një studente e diplomuar, dhe shumë përfaqësues të tjerë të OJF-ve iu bashkuan tubimeve rinore në Tiranë. “E premtja për të ardhmen” u bë një ombrellë për të gjithë të rinjtë në mbarë vendin për të adresuar çështjen e ndryshimeve klimatike te vendimmarrësit. Në këtë kuadër, lëvizjes iu bashkuan shumë organizata, aktivistë, komunitete vulnerabël dhe nxënës të shkollave të mesme dhe të rinj në të gjithë vendin. REC Albania mbështeti aktivizmin rinor përmes projektit “Rrjeti i klimës” duke mbështetur elementë vizuale të fushatës. Gjatë pandemisë Covid-19, u zhvilluan elementë novatorë si biçikleta “Klima” dhe pankarta të mëdha, të cilat u vendosën nëpër qytet.

Me një zë më të fortë së bashku, të rinjtë e “E Premtë për të Ardhmen” në Shqipëri panë që vëmendja e vendimmarrësve ishte tashmë e dukshme duke ofruar mundësinë për diskutim dhe dialog. Një dëgjese publike me Komisionin Parlamentar për projektligjin për Klimën u mbajt në nëntor 2020, ku përfaqësues të OJF-ve artikuluan nevojën për objektiva më agresive në agjendën e klimës. Këto OJF aktive kanë vendosur hapat e parë të qendrueshëm drejt një lëvizje më të fortë për klimën në Shqipëri

Qendra Sociale Murialdo

Viti i themelimit: 1995

Drejtor ekzekutiv: **Giovanni Salustri**

Misioni



Misioni i QSM është zhvillimi njerëzor, formimi profesional dhe arsimor dhe përfshirja sociale e të rinjve. Tre fushat e saj kryesore të veprimtarisë janë:

- a) Formimi Profesional dhe Arsimor (FPA) për të rinjtë (14-26 vjeç);*
- b) Përfshirja sociale e grupeve vulnerabël si romët, fëmijët me aftësi të kufizuara, të burgosurit e rinj dhe viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore dhe*
- c) Mënyra aktive e jetesës dhe qytetaria e të rinjve.*

Adresa:

Rruga: Shën Leonardo Murialdo, 48,
Fier, Shqipëri.

Telefon: +355 695288909

| www.facebook.com/Qendra-Sociale-Murialdo-336990703059572/

Rreth projektit

Ndërthurje: Të drejtat, aftësitë dhe përpunimi i tekstileve për gratë rome në Drizë.

Objektivat e projektit:

Projekti synon të kontribuojë në integrimin socio-ekonomik të komunitetit rom, nëpërmjet promovimit të fuqizimit të grave rome, duke u dhënë atyre kapacitetin për të përcaktuar zgjedhjet e tyre në jetë dhe për të ndjekur qëllimet e tyre dhe për të hequr barrierat sociale dhe kulturore. Për më tepër, projekti i propozuar promovon integrimin e të rinjve dhe fëmijëve romë, përmes dialogut ndërkulturor për të reduktuar pabarazitë sociale.

Zona prioritare tematike: Mosdiskriminimi dhe grupet e marginalizuara

Koha e implementimit: 1/1/2020 - 31/12/2020

Mbulimi gjeografik: Drizë, Fier, Kombëtar



Integrimi i një gruaje rome, shembull pozitiv i arsimimit dhe pavarësisë ekonomike brenda komunitetit rom në Drizë, Fier

"B.A." është një grua 32 vjeçare, analfabete dhe e pamartuar. Për disa arsye, kryesisht për shkak të problemeve shëndetësore që në fëmijëri, ajo nuk ka shkuar kurrë në shkollë dhe nuk ka marrë asnjëherë mbështetje nga familja e saj, siç e përcaktojnë normat tradicionale të grupit të saj kulturor. Gjatë adoleshencës, ajo ka jetuar gjithmonë me nënën e saj, duke e ndihmuar atë të rrisë vëllezërit dhe motrën e saj dhe të mirëmbajë shtëpinë. Këto kushte ishin një disavantazh më shumë për të, pasi u bë plotësisht e varur nga nëna dhe nga familja e vëllait me të cilët jetonte. Ndërkohë, të afërmit e saj kanë marrë pjesë aktive në aktivitetet e organizuara nga QSM në fshat. Që nga hapja e Qendrës "Filli i Drizës" në fshat, "B" ka qenë gjithmonë pjesëmarrëse në të gjitha aktivitetet, së bashku me 203 femrat që kanë pasur akses në qendër në një farë mënyre. Në qendër ajo filloi fillimisht kursin e shkrim-leximit. Më pas, ajo mori pjesë në të gjitha workshop-et për aftësitë ekonomike dhe financiare, vetëvendosjen dhe ndërgjegjësimin për të drejtat. Në veçanti, ajo ka mësuar se si të përdorë tezgjahun dhe tani është në gjendje të prodhojë punime të bukura dhe të mirë rafinuara. Ajo prodhoi pëlhura të ndryshme që u përdorën më pas për të krijuar çanta, kuleta dhe valixhe, të cilat u shitën më vonë dhe kontribuan në krijimin e një tregu fillestar (së bashku me gratë tjera rome). Falë këtij aktiviteti, ajo fitoi pavarësinë nga familja e saj dhe rriti ndjenjën e vlerësimit për aftësitë e saj. Projekti Ndërthurje: Të drejtat, aftësitë dhe përpunimi i tekstileve për gratë rome të Drizës, zbatuar nga Qendra Sociale Murialdo, mundësoi krijimin e një qendre të grave në fshatin Drizë (Fier), e cila u shndërrua në një "zonë sigurie" ku gratë mund të flisnin dhe takoheshin lirisht. Të gjitha gratë që morën pjesë në aktivitetet e qendrës fituan aftësi profesionale dhe sociale, si këmbëngulja, metodologjia e punës dhe planifikimi i punës, të cilat tani mund t'i aplikojnë në tregun lokal të punës. Duke marrë parasysh shitjet e muajve të fundit, "B" dhe gratë e tjera të qendrës, kanë kontribuar në të ardhurat e familjeve të tyre, duke rritur rolin e tyre brenda familjeve.

Instituti i Kulturës Rome në Shqipëri (IRCA)

36

Viti i themelimit: 2011

Drejtor Ekzekutiv: Bledar Taho

Misioni



Advokimi për aksesin e barabartë të Romëve në të drejtat e qytetarëve si dhe në shërbimet publike dhe sociale; Ofrimi i këshillave për arsimim dhe karrierë për studentët Romë; Rritja e kapaciteteve të të rinjve Romë për pjesëmarrje në jetën publike; Kryerja e studimeve kërkimore për dokumentimin dhe institucionalizimin e trashëgimisë kulturore Rome; Promovimi i shkëmbimit ndërkulturor dhe i marrëdhënieve miqësore ndërmjet të rinjve Romë dhe jo-Romë brenda dhe jashtë vendit.

Adresa:

Rruga: Myslym Shyri, 24/b – P.O. 154,
Tiranë 1001, Shqipëri.

Fiks: +355 42425717

Telefon: +355 696187840

| www.irca.al

Rreth projektit

PO – integritit të pakicave kombëtare në Shqipëri.

Objektivat e projektit:

Të kontribuojë në reduktimin e paragjytimeve racore dhe qëndrimeve intolerante ndaj pakicave kombëtare përmes promovimit të diversitetit dhe dialogut ndërkulturor.

- Rritja e ndërgjegjësimit publik për rëndësinë e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe luftës kundër diskriminimit racor.
- Të ndërtojë kapacitetet e të rinjve në dialogun ndërkulturor dhe advokimin dhe t'i angazhojë ata në punën për të rinjtë.
- Të promovojë identitetin, kulturën dhe vlerat e pakicave kombëtare.

Fusha prioritare tematike: *Mosdiskriminimi dhe grupet e marginalizuara*

Koha e implementimit: 15/10/2021- 15/10/2022

Mbulimi gjeografik: *Kombëtar*



Rritja e ndërgjegjësimit dhe të drejtat e pakicave kombëtare

Projekti "PO – integritet të pakicave kombëtare në Shqipëri", mbledhi së bashku përfaqësues të pakicave kombëtare, kryesisht të rinj, duke ofruar mundësinë për të krijuar kontakte me njëri-tjetrin, të marrin pjesë në aktivitete ndërgjegjëse që promovojnë identitetin e pakicave kombëtare dhe të ndërmarrin veprime të përbashkëta advokuese. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komiteti për Pakicat Kombëtare dhe Bashkia Tiranë ishin institucionet kryesore të synuara, të angazhuara në aktivitetet promovuese dhe tryezat e advokimit.

Miratimi i akteve nënligjore të ligjit nr. 96/2017 "Për mbrojtjen e pakicave kombëtare" ishte një nga arritjet kryesore të kësaj nisme. Në përmbushje të detyrimeve kushtetuese dhe ndërkombëtare, Shqipëria ka miratuar ligjin nr. 96/2017 "Për mbrojtjen e pakicave kombëtare", por 9 nga 12 akte nënligjore janë miratuar deri më tani. IRCA ndërmori një fushatë advokimi për të adresuar 3 aktet e mbetura nënligjore si: "Krijimi i një Komiteti ad hoc për njohjen e minoriteteve", "Përdorimi i gjuhës në marrëdhëniet me autoritetet vendore" dhe "Mbledhja e të dhënave bazuar në vetëidentifikimin".

Tryezat e advokimit kontribuan në diskutimin dhe adresimin e çështjeve të mëposhtme të rëndësishme si: 1) *Përcaktimi i formës dhe përmbajtjes së kërkesës për njohjen e minoriteteve të tjera dhe dokumentacionit historik shoqëruar, përcaktimi i afateve kohore që shmangin njohjen e pajustificuar të komuniteteve që janë vendosur në Shqipëri me statusin e azilkërkuar ose emigrantit pas një date të caktuar;* 2) *Identifikimi i personave që u përkasin pakicave të njohura duhet të bazohet në parimin themelor të vetëidentifikimit, në dimensione individuale dhe komunitare dhe në përputhje me jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, e cila shfuqizoi si të papajtueshme me Kushtetutën, Kompetencën e Regjistrimit Civil -për administrimin e të dhënave në lidhje me karakteristikat dalluese të pakicave;* 3) *Mundësimi i përdorimit të gjuhëve të pakicave dhe lehtësimi i komunikimit ndërkulturor për të siguruar akses të barabartë në shërbimet publike si dhe gjatë zhvillimit të proceseve zgjedhore dhe në marrëdhëniet me organet e ligj zbatuese; dhe* 4) *Përgatitja e teksteve shkollore për mësimin e gjuhës rome si dhe mbështetja financiare dhe trajnimi i mësuesve dhe instruktorëve të gjuhës rome që kanë kualifikime alternative.*

Viti i themelimit: 2011

Drejtor Ekzekutiv: Eda Noçka

Misioni



ALTRI synon të arrijë objektivat e tij, kryesisht nëpërmjet kryerjes së studimit, vlerësimit, hartimit të ligjeve, ndërgjegjësimit, ngritjes së kapaciteteve dhe në të njëjtën kohë advokimit dhe lobimit në lidhje me çështjet e mirëqeverisjes, sundimit të ligjit, të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, fuqizimi i grupeve vulnerabël (gratë dhe vajzat, të rinjtë, migrantët e kthyer, personat me aftësi të kufizuara), decentralizimi dhe integrimi në BE, në dritën e përafrimit të legjislacionit kombëtar me atë evropian.

Adresa:

Rruga: Asim Zeneli, Nr. 15, Tiranë, Shqipëri.

Telefon: +355 692050676

E-mail: qendra.altri@gmail.com

| www.altri.al

Rreth projektit

Përmirësimi i mjedisit mediatik për të siguruar një politikë të tolerancës zero për frikësimin dhe sulmet kundër gazetarëve.

Objektivat e projektit:

Projekti kontribuoi në përmirësimin e mjedisit mediatik për të siguruar një politikë të tolerancës zero për frikësimin dhe sulmet kundër gazetarëve, nëpërmjet tre ndërhyrjeve kryesore: a) identifikimi dhe vlerësimi i rasteve, analiza e praktikës gjyqësore dhe prokurorisë për të dhënë rekomandime se si të promovimi dhe garantimi i lirisë së shprehjes. b) krijimi i praktikës së vazhdueshme për identifikimin dhe vlerësimin e rasteve të gazetarëve duke krijuar një bazë të dhënash; c) rritja e ndërgjegjësimit të politikëbërësve (parlamenti, qeveria dhe institucionet e pavarura), gazetarët, policia, gjyqtarët, prokurorët dhe OJQ-të që operojnë në fushën e medias për statistikën dhe historikun e rasteve kundër gazetarëve, duke inkurajuar reagimin e tyre për zbatimin e rekomandimeve dhe për të vazhduar monitorimin e rasteve.

Fusha prioritare tematike: Mediat e pavarura

Koha e implementimit: 15/10/2021 – 15/10/2022

Mbulimi gjeografik: Tiranë, Vlorë, Shkodër, Gjirokastër, Korçë dhe Elbasan



“Për çështje gjyqësore penale dhe civile që përfshijnë gazetarë dhe përfaqësues të medias në kuadër të garantimit të një politike të tolerancës zero për kanosjen dhe sulmet ndaj gazetarëve”

Produkti kryesor dhe shumë i rëndësishëm i arritur nga realizimi i këtij projekti është hartimi për herë të parë i studimit “Për çështjet gjyqësore penale dhe civile ku përfshihen gazetarë dhe përfaqësues të medias në kuadër të garantimit të një politike të tolerancës zero për kanosjen dhe sulmet kundër gazetarëve”. Studimi nuk ka synuar vetëm identifikimin e çështjeve gjyqësore (penale dhe civile), por edhe analizimin e ecurisë dhe trajtimit të tyre sipas standardeve evropiane. Risia që solli ky studim konstiston në:

- Identifikimin e çështjeve gjyqësore civile dhe penale që përfshijnë gazetarë dhe përfaqësues të mediave në nivel kombëtar (2020-2021);
- Përcaktimin e metodologjisë së mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave;
- Analizën e 30 vendimeve gjyqësore (civile dhe penale) të gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë për të parë dhe vlerësuar nëse gjyqtarët gjatë arsytimit të tyre iu referuan vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut për lirinë e shprehjes dhe medias;

Studimi sjell për herë të parë gjurmimin në gjykatë të 107 rasteve konkrete të identifikuara nga media dhe raportimeve (track record) për të kuptuar nëse për një rast të raportuar në media si shpifje, fyerje, sulm, ngacmim apo bullizëm, ka nisur një proces gjykimi dhe cila ka qenë ecuria e çështjes në të gjitha shkallët e gjykimit si dhe disponimi i vendimit të dhënë.

Një nga arritjet e projektit është zbatimi i një prej rekomandimeve të nxjerra nga studimi, ku Ministria e Drejtësisë ka konsideruar nevojën për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave për çështjet gjyqësore ku përfshihen gazetarët, në kuadër të hartimit të statistikave vjetore. Gjithashtu, në kuadër të negociatave me Bashkimin Evropian, dhe konkretisht komponentit të medias dhe lirisë së shprehjes, të dhënat e mbledhura në këtë studim janë të nevojshme jo vetëm për vlerësimin e Komisionit Evropian si dhe përmbushjen e standardeve evropiane, por i shërbejnë edhe institucioneve të tjera në drejtim të përmirësimit të situatës aktuale.

Përmes këtij studimi, institucionet përgjegjëse do të kenë një metodologji për identifikimin dhe analizimin e çështjeve gjyqësore (penale dhe civile ndaj gazetarëve në kuadër të lirisë së shprehjes dhe medias), e cila mund të ndryshohet dhe përmirësohet më vonë. Gjithashtu, studimi kontribuon që politikëbërësit (parlamenti dhe qeveria) të kenë një pasqyrë të plotë të statistikave që lidhen me ndërhyrjen e politikës dhe biznesit në lirinë e medias, standardet ndërkombëtare dhe të BE-së për garantimin e lirisë së medias që mund të kontribuojë edhe për rishikimin aktual të projektligjit për mediat. Projekti u zhvillua në nivel kombëtar, ndërsa aktivitetet e advokimit dhe informimit u zhvilluan në 6 qytete: Lezhë, Shkodër, Lushnjë, Vlorë, Elbasan dhe Korçë. Aktorët kryesorë të këtij projekti janë: Ministria e Drejtësisë, Kuvendi i Shqipërisë, Gjykatat e rretheve gjyqësore dhe Prokuroria, Unioni i Gazetarëve Shqiptarë, përfaqësues të mediave dhe organizatave të shoqërisë civile.

Qendra Streha

Viti i themelimit: 2015

Drejtor Ekzekutiv: **Adelajda Alikaj**

Misioni



Misioni i Qendrës Streha është të mbështesë të rinjtë LGBTI+ përmes shërbimeve multidisiplinare, duke i fuqizuar ata për të kapërcyer sfidat e ngritura nga shoqëria me qëllim integrimin e tyre në shoqëri.

Adresa:

Rruga: Naim Frashëri, 75, Tiranë,
Shqipëri.

Telefon: +355 699839189

[|www.strehacenter.org](http://www.strehacenter.org)

Rreth projektit

Përmirësimi i situatës së personave LGBTI+ në Shqipëri.

Objektivat e projektit:

Për të përmirësuar situatën e personave LGBTI+ në Shqipëri përmes fuqizimit të profesionistëve vendas dhe ndryshimit të stereotipeve negative.

Fusha prioritare tematike: *Mosdiskriminimi dhe grupet e marginalizuara*

Koha e implementimit: *3/11/2021 - 3/11/2022*

Mbulimi gjeografik: *Tiranë, Korçë, Fier, Shkodër.*



Historia e Anës, një histori suksesi

Ana është një vajzë transgjimore 28-vjeçare, e cila kërkoi ndihmën e Qendrës “Streha” në një moment shumë kritik të jetës së saj. Pas 6 vitesh punë si punëtore seksi, vuajtje nga varësia ndaj drogës dhe histori abuzimi në familje, ajo vendos të largohet nga qyteti i lindjes. Ana kontaktoi “Strehën” dhe pas disa intervistave dhe vlerësimit të situatës së saj, ajo u bë pjesë e qendrës, e cila është një hapësirë e sigurt dhe pranuese për të gjithë komunitetin LGBTI+, i cili përballet me dhunë, diskriminim dhe ka më pak shanse për një jetë dinjitoze për shkak të orientimit seksual.

Ekipi multidisiplinor bëri një vlerësim të situatës së saj mjekësore, psikologjike dhe ligjore dhe ofroi mbështetje të vazhdueshme për Anën për ta ndihmuar atë të ri-integrohet në një mjedis të ri dhe gjithashtu të përmirësojë aftësitë e saj sociale dhe të rrisë kapacitetet e saj në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Ana e cila kishte lënë shkollën e mesme, pohon se: “Në familjen time shkollimi nuk është traditë, por edhe nuk e bëja dot. Në moshën e gjimnazit, bashkëmoshatarët ishin edhe më agresivë, nuk mund të ndryshoja sjelljen time edhe pse u përpoqa për shumë vite, më shënjestronin si “gay” apo ndonjëherë “vajza” dhe shumë ofendime e dhunë fizike ndodhnin gati përditë”.

Në kuadër të projektit Ana mbështetet me kursin e gjuhës angleze. Ndërkohë Ana filloi punën e saj të parë në një kompani shërbimi pastrimi dhe për momentin ka arritur të ketë kursimet e saj për t'u bërë e pavarur ekonomikisht dhe për të përballuar jetesën e saj, si një synim afatgjatë. Ajo synon të përmirësojë aftësitë e saj në anglisht dhe puna në një call center është qëllimi i saj i ri. Ana ka pasur një përmirësim të dukshëm në aspektin shëndetësor për shkak të referimit në institucionet shëndetësore (mjeku i familjes, Instituti i Shëndetit Publik). Ajo u diagnostikua me HIV dhe është referuar në “Klinikën Ambulatore për HIV dhe IST”. Me asistencë në referim dhe procedura, ajo tashmë është pjesë e skemës për pacientët me HIV në Shqipëri dhe përfiton trajtim falas.

Duke bashkëpunuar ngushtë me stafin psiko-social të qendrës Streha ajo ka arritur të punojë fort për objektivat e saj për të nisur një jetë të re dhe për t'u ndierë e integruar në shoqëri. Gjatë eventit Gala që organizoi “Streha”, Ana u vesh, bëri grim dhe rregulloi flokët pas një kohe të gjatë, dhe e shijoi shumë mbrëmjen ku u ndje me të vërtetë vetvetja dhe citoi: *“Më pëlqeu shumë eventi, më pëlqeu të isha pranë kaq shumë njerëzve që erdhën këtu për të na mbështetur. U ndjeva e pranuar dhe e dashur nga shumë njerëz ashtu siç jam, nuk kisha nevojë të fshihesha apo të shpjegoja! Mbrëmja më bëri shumë të lumtur”*. Ana paraqet progres të dukshëm në zhvillimin personal, social dhe profesional dhe është vlerësuar nga stafi i “Streha” si një rast suksesi në procesin e gjatë të ri-integrimit dhe fuqizimit. Ajo që e bën më të suksesshme është vetë-motivimi dhe këmbëngulja që ajo ka pasur gjatë gjithë kësaj periudhe për të ndryshuar rrjedhën e jetës së saj.

Lëvizja “Mjaft”

Viti i themelimit: 2006

Executive Director: Aldo Merkoci

Misioni



Misioni i organizatës është promovimi i qytetarisë aktive, forcimi i komuniteteve, promovimin e qeverisjes së përgjegjshme dhe përmirësimin e imazhit të Shqipërisë në botë.

Adresa:

Rruga: Jul Variboba, 1, Ap. 5, Tiranë, Shqipëri.

| www.mjaft.org

Rreth projektit

Llogaridhënia, Teknologjia dhe Hapja Institucionale në Shqipëri – Vepro Shqipëri.

Objektivat e projektit:

Sigurimi i mjedisit mundësues për qeverisje të mirë në Shqipëri, nxitja e hapjes së institucioneve publike dhe forcimi i shoqërisë civile dhe të rinjve për të marrë pjesë në procesin e sundimit të ligjit.

Fusha prioritare tematike: *Lufta kundër korrupsionit*

Koha e implementimit: *15/10/2021 – 9/12/2022*

Mbulimi gjeografik: *Kombëtar*



Llogaridhënia, Teknologjia dhe Hapja Institucionale Shqipëri – “VePro Shqipëri”

Gjykata e Apelit Tiranë ka shënuar performancën më të ulët ndër gjykatat e apelit në Republikën e Shqipërisë. Sipas treguesve që masin hapjen e institucioneve - gjykata është në nivelin 34.83% - sipas metodologjisë së monitorimit të “VePro Shqipëri”, bazuar në standardet ndërkombëtare të transparencës dhe llogaridhënies. Gjatë prezantimit të gjetjeve kryesore të Indeksit Kombëtar të Hapjes, për organet e drejtësisë, kjo gjykatë u prezantua nga kanalet mediatike si institucioni me performancën më të ulët në përmbushjen e këtyre standardeve. Menjëherë pas prezantimit në media, gjyqtarja e kësaj gjykate, znj. Edlira Petri, kontaktoi me MJAFT për të kërkuar një takim në ambientet e tyre dhe për të zhvilluar një trajnim të shkurtër me stafin, me qëllim përmirësimin e performancës së tyre. Në javën e fundit të nëntorit 2022, Mjaft zhvilloi dy takime me znj. Petri dhe Koordinatorën për të Drejtën për Informim, znj. Jonida Capo. Gjithashtu, Mjaft ndërmjetësoi për organizimin e një seance trajnimit për këtë institucion me pjesëmarrjen e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën për Informim dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në dobi të stafit administrativ të Gjykatës së Apelit Tiranë. Pas trajnimit, performanca e institucionit është rritur me 39,42 %. Gjykata e Apelit Tiranë ka rritur transparencën duke iu përgjigjur pyetësorit të hartuar dhe duke publikuar dokumente që lidhen me: CV-të e stafit, planet dhe raportet vjetore të punës, strategjitë aktuale, komunikimin me median, trajnimet për të drejtën për informim, dhe anti-korrupsionin, aksesueshmërinë e sallave të gjyqit, publikimin e çështjeve ndaj të miturve, kodin e etikës, statistikave vjetore të institucionit etj. Aktualisht, Gjykata e Apelit Tiranë përfaqëson institucionin më të hapur në Republikën e Shqipërisë, në përmbushjen e pjesës më të madhe të treguesve bazuar në dokumentet e publikuara në faqen e saj, informacionin e dhënë nëpërmjet pyetësorit dhe kuadrin ligjor në fuqi në vendin tonë. Është e rëndësishme të theksohet se institucioni është i angazhuar për të rritur pikët e tyre në të ardhmen e afërt, ndërkohë që po punohet për hartimin e dokumenteve të kërkuara për arritjen e standardeve ndërkombëtare të qeverisjes së mirë dhe Mjaft do të ofrojë ndihmën e saj në këtë proces.

“Qendra Sociale në Ndhimë të Njerëzve në Nevojë” Fushë-Arrëz (QSNNN)

Viti i themelimit: 2014

Drejtor Ekzekutiv: Hil Curri

Misioni



Misioni ynë është të mbështesim, mobilizojmë dhe aktivizojmë në jetën shoqërore dhe vendimmarrje të rinjtë dhe gratë; kujdesi për moshën e tretë dhe ndërmarrja e nismave ndërgjegjësuese për mbrojtjen e mjedisit, pyjeve, florës dhe faunës; studimi i trendeve të zhvillimit dhe problemeve me të cilat përballet komuniteti gjatë proceseve të zhvillimit.

Adresa:

Rruga: “Demokracia”, Ish-Zdruktaria,
Kati 2-të, Fushë-Arrëz 4402, Shqipëri.

Telefon: +355 686419378

E-mail: shoqata_qsnnn@hotmail.com

| www.qsnnn.org

Rreth projektit

Angazhimi i të rinjve të Pukës dhe Fushë-Arrëzit në Mbrojtjen e Mjedisit.

Objektivat e projektit:

Objektivi i përgjithshëm i projektit është të sigurojë hapësira të reja për qytetari aktive për të rinjtë për të promovuar Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe politikat e mira mjedisore lokale.

Fusha prioritare tematike: Mbrojtja e mjedisit

Koha e implemenimit: 15/10/2021 – 15/10/2022

Mbulimi gjeografik: Bashkia Fushë-Arrëz dhe Pukë.



Të rinjtë promovojnë SDG-të dhe politika të mira mjedisore lokale në Pukë dhe Fushë-Arrëz

Një nga problemet më të mëdha në shkallë botërore sot është mbrojtja e mjedisit, e cila ka prekur edhe zonat e Fushë-Arrëzit dhe Pukës. Këto dy zona njihen si dy nga vendet me biodiversitetin më të lartë dhe natyrë të mrekullueshme në Shqipëri. Pas vitit 1990, keqmanaxhimi i mbetjeve u bë një problem serioz. Ndërhyrje të paligjshme në pyje si: prerja e paligjshme, zjarret masive, humbja e sipërfaqeve pyjore, erozioni, dëmtimi i florës dhe faunës, kanë sjellë ndikim në jetën e komuniteteve Pukë dhe Fushë-Arrëz. Të rinj nga Shkolla e Mesme e Bashkuar "8-Dhjetori", Qelez-Pukë, Gjimnazi Fushë-Arrëz dhe të rinj nga komuniteti u mblodhën për të vënë në plan të parë "Objektivat e Zhvillimit të Qendrushëm" (SDG-të) në nivel lokal. Sjellja miqësore me mjedisin u inkurajua përmes angazhimit të drejtpërdrejtë të të rinjve si promovuesit më të mirë të SDG-ve në komunitetet lokale.

Në të gjitha aktivitetet e projektit mori pjesë Griselda Topjanasi, nxënëse e shkëlqyer e Shkollës së Mesme të Bashkuar "8-Dhjetori", Qelez-Pukë dhe drejtuese e grupit "Change Makers". Gjithashtu, duke qenë pjesë e të gjitha takimeve të organizuara mes të rinjve dhe Bashkisë Pukë, ajo prezantoi të gjitha problemet që lidhen me manaxhimin e mbetjeve dhe rehabilitimin e sipërfaqeve pyjore të dëmtuara ndër vite në Pukë, duke kërkuar më shumë buxhet nga bashkia për çështjet mjedisore që ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e komunitetit. Në mbledhjen e Këshillit Bashkiak Pukë, Griselda së bashku me të rinjtë e tjerë të grupit "Change Makers", paraqitën kërkesa për çështje mjedisore të cilat u mirëpritën nga Këshilli Bashkiak Pukë me premtimin se do të merren parasysh për buxhetin e vitit 2023. Të rinjtë e Qelezit zbatuan me sukses planin e ndërhyrjes së përzgjedhur nga një juri profesionale në konkursin mjedisor "Të rinjtë në Qelez promovojnë SDG-të". Në ambientet publike u mbollën pemë dekorative, u vendosën kosha mbeturinash në ambientet e jashtme dhe të brendshme të shkollës, si dhe lule dekorative. Kjo ndërhyrje pasqyrore drejtpërdrejt veprimet lokale në përmbushje të Objektivave Specifike të Zhvillimit të Qendrushëm nr. 12 dhe nr. 15. Tashmë janë vendosur të gjitha urat e komunikimit me pushtetin vendor. Zbatimi i veprimeve konkrete shërbeu si një shembull i mirë i komunitetit rinor në Pukë dhe Fushë-Arrëz për t'u ndjekur në të ardhmen nga pushteti vendor si një detyrim ligjor për përmbushjen e misionit të tij.

| PROGRAMI I SHOQËRISË CIVILE PËR SHQIPËRINË DHE KOSOVËN

Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim



partners@partnersalbania.org



www.partnersalbania.org

2022